



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:063456
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05447952

KA.nr.504/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Alba PETROL Group” Sh.P.K. me numër fiskal 601736624 dhe seli në rrugën “Rexhep Bislimi” p.nr. në Viti, kundër të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit administrativ, jashtë seancës, më datën 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia e paditësit “Alba PETROL Group” Sh.P.K me numër fiskal 601736624, për anulimin e vendimit nr. 30/2020 të datës 06 maj 2020 së të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

A R S Y E T I M

Paditësi më 30.05.2020 ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 30/2020 të datës 06.05.2020 së të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se padia ka të meta pa evitimin e të cilave nuk mund të procedohet tutje, rrjedhimisht më 22.02.2024 mori aktvendimin KA.nr.504/22, me të cilin e ftoi Paditësin që t’i evitoj të metat e evidentuara nga gjykata. Me atë aktvendim gjykata gjithashtu e paralajmëroi Paditësin se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, atëherë gjykata do ta hedhë poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Gjykata konstaton se Paditësi më 27.02.2024 e ka pranuar aktvendimin KA.nr.504/22 të datës 23.02.2024, , ndërsa deri me datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të dhëna në aktvendimin e cekur më lartë. Sipas nenit 33 para. 2 të LKA-së “Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të

atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”

Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të caktuara në aktvendimin për korrigjimin e padisë, ndonëse ishte i paraplajmëruar për pasojat, atëherë gjykata në bazë të nenit 33 para. 2 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.504/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.